



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Republika e Kosovës - Republika e Kosovo
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica - Municipality of Gjakova

ARKIVA DALËSE
IZLAZNE ARHIVE
OUTPUT ARCHIVES

Nr. Inv./Br. Inv. 01-020701-39788
Data/Dat. 08.07.2025

Kuvendi i Komunës - Gjakovë /
01 Nr. Gjakovë - Djakovica - Gjakova /2025

Datë. 31.07.2025

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12. të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në Rregulloren Nr. 04/2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, dhe nenit 15 pika 1 të Rregullores 01 nr. 110/01-3560/2020 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës të datës 30.01.2020, në mbledhjen e mbajtur me datë 31.07.2025, pas diskutimeve lidhur me pikën e 6 të rendit të ditës: Propozim Vendim për mbështetje financiare të Shoqatës “Handikos Gjakova”, e miratoi këtë:

V E N D I M

Për

mbështetje financiare të shoqatës “Handikos Gjakova”

1. Miratohet mbështetja financiare e Shoqatës “Handikos Gjakova” sipas rekomandimit të Komisionit Vlerësues bazuar në Thirrjen Publike për Projekte dhe Programe të OJQ-ve në fushën e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për mbështetje financiare në vlerë prej 25.000€ me qëllim të përkrahjes për realizimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara që ofrohen nga “Handikos Gjakova”.
2. Mjetet financiare për Shoqatën “Handikos Gjakova” ndahen nga Kategoria e Subvencioneve Komunale të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale nga Kodi buxhetor: 21/632/73950/00000/0721, në vlerë prej 25,000€.
3. Obligohen organet e Administratës Komunale për kryerjen e të gjitha procedurave në harmoni me të gjitha aktet ligjore në fuqi, për ekzekutimin e mjeteve financiare sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.
5. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini.
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
 - Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
 - Arkivit.

Arbëneshja Kuqi
Kryesuesja e Kuvendit të Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data/nr	11.07.2025 <u>40065-35397</u>
Për:	Arbënesha Kuqi, Kryesuese Kuvendit të Komunës së Gjakovës
CC:	- Të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës - Arkivit
Nga:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
Lënda:	Propozim vendim për mbështetje financiare të shoqatës “Handikos Gjakova”



Të nderuar,

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 58 shkronja h të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 46 shkronja h të Statutit të Komunës së Gjakovës, si dhe në bazë të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës, me datën 11.07.2025 e parashtron në Kuvendin e Komunës së Gjakovës këtë:

P R O P O Z I M V E N D I M

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës të miratojë vendimin për mbështetje financiare të Shoqatës “Handikos Gjakova”, sipas rekomandimit të Komisionit Vlerësues, bazuar thirrjes publike për projekte/programë të OJQ- ve, në fushën e shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
2. Mjetet për mbështetje financiare për Shoqatën “Handikos Gjakova”, të ndahen nga kategoria e subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale nga kodi buxhetor 21/632/73950/2000/00000/0721, në vlerë prej 25,000€.
3. Obligohen organet e administratës për kryerjen e të gjitha procedurave në harmoni me gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për ekzekutimin e mjeteve financiare sipas pikës së dytë të këtij Propozim -Vendimi.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data:	11.07.2025
Për:	z. Ardian Gjini – Kryetar i Komunës së Gjakovës
Nga:	Dafina Kazazi-Olloni – Kryesuese i Komisionit
Përmes:	Adelina Shehu –Kola drejtoreshë për Drejtori te Shëndetësisë dhe Mireqenies Sociale
Tema:	Rekomandim për aprovim



I nderuari z. Kryetar,

Në procesin e Thirrjes Publike për mbështetje financiare të projekteve / programeve për OJQ-të në fushën e Shëndetësisë dhe Mireqenies Sociale të hapur nga DSHMS, është pranuar edhe kërkesa e OJQ "Handikos Gjakove"

Meqë, OJQ "Handikos Gjakove" veprimtarinë e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale e bazon në Planin Vjetor të Punës, për realizimin e së cilës kërkohet vlerë e lartë e mjeteve financiare për subvencionim, gjithashtu duke u bazuar në përfaqësimin, kontributin dhe përkrahjen e personave me aftësi të kufizuar duke avokuar dhe lobuar, dhe duke ofruar shërbime të rehabilitimit të bazuar në komunitet për të arritur të drejta të barabarta, për një jete të pavarur dhe të dinjitetshme për të gjithë

Kësisoj duke ofruar:

1. Ofrim i shërbimeve bio psikosociale për persona me aftësi të kufizuar
2. Ofrim i shërbimeve në përmirësimin e shëndetit të personave me aftësi të kufizuar dhe,
3. Përmirësimi i kushteve të jetës dhe ngritja e mirëqenies së personave me aftësi të kufizuar përmes ofrimit të shërbimeve dhe shërbimeve psiko sociale në shtëpi.

Komisioni ka propozuar që për realizimin e këtij projekti, të rekomandoj shumë në vlerë prej 25,000.00 euro.

Andaj, rekomandojmë kryetarin e Komunës që të aprovoj shumë në vlerë prej 25,000.00 euro nga Kodi Buxhetor 10/632/73950/200/00000/0721 dhe të njëjtën ta procedoj për miratim në Kuvendin Komunal.

Gjeni të bashkangjitur:

Projekt - Aplikacionin për mbështetje financiare të parashtruar nga OJQ "Handikos Gjakove"

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DREJTORIA E SHENDETESISË DHE MIREQENIES SOCIALE

Komisioni Vlerësues i Thirrjes Publike sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës së Gjakovës me nr 01-112/02-11990, sipas Thirrjes Publike të OJQ-ve në fushën e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me datë 02.07.2025 nxjerr Vendim përfundimtar për OJQ-te të cilat i kanë plotësuar kriteret për subvencionim sipas Thirrjes Publike, të renditura si në vijim;

NR:	Emri i OJQ-se	Emri i Projektit
1.	Shoqata e paraplegjikeve dhe paralizës së fëmijëve të Gjakovës Handikos Gjakovë	“Ofrimi i shërbimeve bio-psikosociale për personat me aftësi të kufizuara”

Vërejtje: Për detaje tjera të gjitha OJQ- të në fushën e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale do të kontaktohen me kohë nga Udhëheqësja e Sektorit të Shëndetësisë.

Anëtarët e komisionit:

- 1.Dafina Kazazi Olloni-kryesuese
- 2.Sharr Mullaxhela -anetar
- 3.Arben Hulaj-anetar
- 4.Shpresa Polloshka-anetar
- 5.Hare Nuza -anetar





REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS



GJAKOVA

Republika e Kosovës / Republika e Kosovës / Republic of Kosovo

Komuna e Gjakovës / Opština Gjakovica / Municipality of Gjakova

ARKIVA DALËSE
IZLAZNE ARHIVE
OUTPUT ARCHIVES

OPŠTINA GJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Nr.Inv/Br.Inv. 05-553101-26592

Data/Datum/Date 26.05.2025

Nr. fazeve/Br. Str./No. Pg. 7

Gjakovë, 26.05.2025

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në harmoni me dispozitat ligjore të Rregullores MF-NR-04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ, bënë këtë:

Thirrje publike për mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve në zbatimin e aktiviteteve të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

1. Ftohen gjitha organizatat jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i të cilave është i fokusuar në fushën e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zbatimin e programit të DSHMS-së së Komunës së Gjakovës i cili i dedikohet sektorëve të personave me nevoja të veçanta.
2. OJQ-të e regjistruara nga MFPT/DPSF në Komunën e Gjakovës, në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet e tyre për ofrimin e shërbimeve sociale.
3. Organizatat jo-qeveritare e regjistruara mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në ofrimin, zbatimin dhe përmirësimin e fokus grupeve në kuader të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies sociale përmes zbatimit të objektivave dhe aktiviteteve si më poshtë:
 - 3.1. Aktivitetet që kanë për qëllim nxitjen e autoriteteve lokale, institucionet publike dhe artereve tjerë për bashkëpunim me shoqërinë civile, në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me nevoja të veçanta, implementimin e programeve të tyre në kuadër të DSHMS-se;
 - 3.2. Mbështetja e aktiviteteve të përgjithshme të edukimit joformal për fushat e Ojq-ve të cilat i ofrojnë në kuadër të DSHMS-se;
 - 3.3. Aktivitetet që synojnë adresimin e problemeve specifike me prioritet duke përfshirës shërbimet rehabilituese sociale, shërbimet bio-psiko sociale dhe shëndetësore dhe fusha tjera të ngjashme;
 - 3.4. Shërbime të rehabilitimit dhe trajtimit programi i të cilave është i fokusuar për personat me nevoja të kufizuar si tetraplegjike, paraplegjike, etj.
 - 3.5. Aktivitetet lidhur me shërbimet e rehabilitimit, socializmit, të personave me aftësi të kufizuar, në kuadër të DSHMS-së;
4. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është **25,000.00** euro. Për OJQ-të të cilat aplikojnë me projekte për zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve shuma minimale e mbështetjes financiare që

mund të alokohet për një (1) projekt është 500.00 euro, ndërsa shuma maksimale për një (1) projekt është 25,000.00 euro.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune duke filluar nga data **26.05.2025** deri me **13.06.2025**.

6. OJQ-të mund të aplikojnë ose të jenë partner në më së shumti vetëm me një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje.

7. Periudha e zbatimit të projektit është brenda vitit.

OJQ mund të përfshihet më së shumti në një (1) projekt dhe të përfshihet në zbatimin e vetëm një (1) fushe prioritare.

8. Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara sipas Udhëzimit Administrativ nr.02/2020 nga MFPT/DPSF-ja.

9. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në ndonjërin nga llojet e fushës dhe aktivitetet të përfshira në kuadër të kësaj thirrje publike.

10. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare.

11. Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-të, duhet të paraqesin prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara.

12. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të Komuna e Gjakovë / <https://gjakova.rks-gov.net/konkurset-njoftimet/>

13. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në Adresa: Rr. "Bardhyl Qaushi" p.n. 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës/ Zyrat e DSHMS ne Kuvendin e Komunës".

14. Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

15. Te drejte aplikimi me projektet e tyre kane Organizatat Jo-Qeveritare qe janë te regjistruara sipas dispozitave ligjore për regjistrimin e organizatave jo qeveritare ne Republikën e Kosovës dhe te cilat veprojnë ne Komunën e Gjakoves, se paku një vit para datës se publikimit te Thirrjes publike.

16. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

17. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen ne zyrat e DSHMS-se..



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DREJTORIA E SHENDETESISË DHE MIREQENIES SOCIALE

Duke u bazuar në nenin 12 dhe 20 të Rregullores nga MF nr 04/2017 mbi kriteret, standardet e procedurave të financimit publik të OJQ-ve, Komisionit Vlerësues i Thirrjes sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës së Gjakovës me 01nr112/02-30873 të datës 16.06.2025, sipas Thirrjes Publike në fushën e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me datë 02.07.2025 nxjerr Vendim për rezultatet paraprake:

Lista paraprake e OJQ-ve aplikuese sipas Thirrjes Publike për financim në fushën e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të renditura si ne vijim:

NR:	Emri i OJQ-se	Emri i Projektit
1.	Shoqata e paraplegjikeve dhe paralizës së fëmijëve të Gjakovës Handikos Gjakovë	“Ofrimi i shërbimeve bio-psikosociale për personat me aftësi të kufizuara”

- OJQ nga Listat paraprake do të kontaktohen nga DSHMS për të dorëzuar dokumentacionin shtesë sipas afateve të parapara në Rregulloren MF-NR.04/2017
- Rezultatet nga Lista Paraprake shndërrohen në Rezultate Përfundimtare, pasi janë kryer të gjitha procedurat dhe afatet e parapara me rregulloren MF-NR.04/2017
- OJQ-të aplikuese kanë të drejtë të parashetrojnë ankesë me shkrim te Komisioni i Ankesave të Komunës së Gjakovës në afat prej 5 ditësh nga dita e publikimit të kësaj liste

Anëtarët e komisionit:

- 1.Dafina Kazazi Olloni-kryesuese
- 2.Sharr Mullaxhela -anëtar
- 3.Arben Hulaj-anëtar
- 4.Shpresa Polloshka-anëtar
- 5.Hare Nuza -anëtar

[Signatures of the Commission Members]





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Procesverbal

Datë:	02.07.2025	Procesmbajtës:	Dafina Kazazi Olloni
Vendi:	Komuna e Gjakovës	Zyra:	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
Takimi filloi:	Date: 02.07.2025 09.00 h	Takimi mbaroi:	Date 02.07.2025 11:00 h
Pjesëmarrës	Dafina Kazazi Olloni – Udhëheqëse e sektorit Shendetesise(DSHMS) - kryesuese Sharr Mullaxhela-zyrtar (DMSH) anëtare , Arben Hulaj-zyrtare (DSHMS) - anëtar Shpresa Berisha eksperte e jashtme – anëtare Hare Nuza -përfaqësuese e OJQ “Qendra Inovative e Gjakoves” anëtare		
Tema/ Agjenda	<i>Takim nje ditore</i> Vlerësimi dhe Shqyrtimi i aplikacioneve te Organizatave Jo Qeveritare ne DSHMS		
Diskutimi	Takimin e udhëhoqi kryesuesja e grupit, ku janë njoftuar pjesëmarrësit me dinamikën e punës, detyrat dhe përgjegjësit e secilit anëtar të Komisionit Vlerësues lidhur me shqyrtimin e aplikacioneve të OJQ-ve. Nga kryesuesja e komisionit , anëtarët gjithashtu janë informuar lidhur me procedurën për themelimin e Komisionit Vlerësues nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, sipas vendimit 01nr112/02-30873 të datës 16.06.2025 në përbërje të kryesuesit të komisionit dhe 4 anëtar të komisionit . Diskutimi: ➤ Njoftimi me Rregulloren 04/2017 nga Ministria e Financave mbi Standardet, Kriteret, dhe procedurat e Financimit Publik për ndarjen e subvencioneve të Organizatave Jo Qeveritare. Është bërë shqyrtimi i dy kërkesave si në aspektin teknik procedural, ashtu dhe në aspektin përmbajtësor. Prioritet në listën e Përfituesve i është dhënë: Organizates Jo Qeveritare e cila i ka plotësuar kriteret sipas Thirrjes Publike e cila ka qenë e hapur nga data 26.05.2025-13.06.2025. Në listën e përfituesve janë:		

	Emri i OJQ-se	Emri i projektit/programit	Totali i pikëve	Shuma e mbeshtetur
	1. Shoqata e paraplegjikeve dhe paralizës se fëmijëve te Gjakoves Handikos Gjakove"	"Ofrimi i shërbimeve bio-psikosociale për personat me aftësi te kufizuara"		25,000.00 euro
Ne listën e Jo përfituesve është "OJQ'ITS worth living /Ia vlen te jetosh"e cila nuk i ka plotësuar kriteret e parapara sipas Thirrjes Publike.				
Përfundimi	Nga 2 aplikacione janë përzgjedhur: 1 - Përfitues, 1- Jo përfitues, Gjithsejtë shuma e parapare e mjeteve për Thirrjen publike është 25,000.00 Euro			

Rekomandim

Komisioni e emëruar, pas shqyrtimit të të gjitha kërkesave i rekomandon Kryetarit të Komunës Z. Ardian Gjini , listën e nënshkruar për vazhdimin e procedurave të mëtejshme .

Anëtarët e komisionit:

1.Dafina Kazazi-Olloni _____

2.Sharr Mullaxhela _____

3.Arben Hulaj _____

4.Shpresa Polloshka _____

5.Hare Nuza _____

